



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-33600 2022

Klinë, 19. 04. 2022

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, e jashtëzakonshme, mbajtur me datë 19. 04. 2022, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit të Komunës e hapi kryesuesi i kuvendit, z. Fadil Gashi. A i përshëndeti të pranishmit në mbledhje dhe ju uroj mirëseardhje. Në emër të kuvendit përshëndeti kryetarin e komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit OSBE-së dhe të tjerë.

Kryesuesi Gashi kërkoj mirëkuptim nga anëtarët e kuvendit që edhe pse është seancë e jashtëzakonshme, të nderojmë me një minutë heshtje ish drejtorin e ndjerë të financave Aziz Desku, pasi që kjo është seanca e parë që mbahet pa prezencën e tij.

Pas nderimit me një minutë heshtje, kryesuesi hapi seancën e jashtëzakonshme duke konstatuar se prezent në sallë janë 26 anëtarë të kuvendit dhe duke theksuar në vazhdim:

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, statusin e kuvendit, rregulloren për transparencë dhe duke u bazuar në kërkesën e anëtarëve të Kuvendit për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, hapi punimet e kësaj seance me një pikë të rendit të ditës që është: Diskutimi rreth respektimit të procedurave ligjore për dhënien e lejes për ndërtim të fabrikës së çimentos, kompanisë "Walingford internacional Kosova" me 25 janar të vitit 2022. Sipas praktikave ata që e kanë thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme do të duhej të marrin fjalën dhe të bëjnë një prezantim të shkurtër.

**z. Zafer Gashi:** Mirëdita për të gjithë. Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale ne kemi bërë një kërkesë në emër të të tri grupeve kuvendare në kuvendin e komunës për diskutim të procedurave ligjore për dhënien e lejes për ndërtim të fabrikës së çimentos ashtu siç e përmendi kryesuesi z. Gashi. Falënderojmë ë kryesuesin z. Gashi për mirëkuptim për shkak se do të ketë diskutues nga asamblistët por do të ketë diskutues edhe nga qytetarët sipas propozimit të grupit kuvendar të PDK-së. Është menduar që të instalohet edhe një video projektor që çdo dokument për të cilin do të flasim të ishte viziv por si duket nuk ishin kushtet.

Është e vërtetë se me datën 25 janar të këtij viti është lëshuar leja për ndërtimin e fabrikës së çimentos në territorin e Klinës dhe kjo është shumë e rrezikshme për jetën e qytetarëve. Nëse bazohemi në planin zhvillimor ekonomik të komunës së Klinës 2014-2021, ky plan i votuar në këtë asamble ka identifikuar tri zona të rëndësishme për zhvillim ekonomik. Zona e parë që është tokë bujqësore- 17% të sipërfaqes së Komunës, zona e dytë, zonë e kombinuar që është 55% dhe zona pyjore- 28%. Në asnjë projektion nuk është që të ketë industri të çimentos. Procedurat ndoshta nuk e mundësojnë që ta marrin sot këtu fjalën



edhe profesorët e nderuar dhe që janë profesionist të kësaj fushe , do të mundohem që të i them disa fjalë dhe të evidentoj disa shkelje ligjore të bëra në dhënien e lejes për ndërtim të kësaj fabrike. Këto fakte kanë data dhe janë me emër të dikastereve të veçanta. Është punuar kundër ligjit dhe është punuar për një kompani që është "Klina Cem" që ka qenë publike dhe del një kompani tjetër pastaj fantome kjo që e merr lejen, ndërsa "Klina cem" nuk ja jep lejen para kësaj të fundit. Sipërfaqja ku do të jetë lokacioni është 35 hektar e 20 ari. Përafërsisht 49 objekte do të ndërtohen në atë lokacion. Shkurt më lejoni. Është një raport vlerësues ku thotë 500 metra është larg shtëpive gjë që sipas tyre nuk ka rrezik, frynë erë lindore, s' ka dridhje, s' ka vibracion thonë në këtë raport. Mund të jenë 7 deri në 8 shkallë të merkalit vibracioni dhe sipas tyre nuk është rrezik ndërsa të nderuar këto shkallë të merkalit janë shkatërruese. Në raport thuhet se s' ka dëme në florën e ambientit por është e kundërta . janë diku 7 lloje të bimëve të veçanta që do të shkatërrohen. Zhurma e cila matet me decibel. Norma e decibelit për një jetë normale është 40-45 decibel ndërsa nga kjo fabrikë do të arrihet deri në 120 decibel. Furra për pjekje të materialeve klinker do të arrijnë deri në nga 1000 deri në 1200 gradë celsius dhe këto furra do të nxehen me thëngjill. Ky thëngjill sipas tyre nuk liron asgjë por në fakt liron dioksid sulfuri, oksid azoti etj. Si profesionalist i fushës së mjekësisë, shkencërisht mund ta gjeni se trupi i njeriut përbëhet edhe metale të rënda. Tri elemente që nga kjo fabrikë lirohen janë merkuri, arseniku, kambiumi, janë elemente kimike që nuk hyjnë në përbërjen e qelizave të njeriut dhe janë kancerogjene. Për dy vite këto tre elemente mund të depërtojnë në tokën bujqësore dhe ne do të ushqehemi nga ajo tokë.

Të nderuar pjesëmarrës, unë kam përzgjedhë se çfarë kanë shkruar mediat kur kanë marr intervista nga strukturat udhëheqëse të Komunës.

z. Gashi në vazhdim përmend deklaratat e kryetarit Elezaj dhënë mediave si kallxo.com, indeksonline, infokus,etj.

Kompeten për lëshimin e lejes për ndërtimin e fabrikës janë institucionet e nivelit qendror thotë z. Elezaj në një media. Sipas ligjit për miniera dhe minerare, komisioni për miniera dhe minerare nuk lëshon leje për ndërtim të fabrikës së çimentos, Komisioni lëshoj leje për hulumtim. Kryetari Elezaj duhet at dijë dallimin mes lejes për ndërtim dhe lejes për hulumtim. Mediat pasqyrojnë edhe seancën e jashtëzakonshme kur ky kuvend ka marr vendim që të shfuqizohen të gjitha lejet e dhëna për ndërtimin e fabrikës së çimentos dhe gurorëve. Është edhe z. Lorenc Marleku që ju ka përgjigj mediave dhe ka deklaruar: vendimi i kuvendit është vendim jo profesional dhe politik, atëherë ka qenë drejtor i urbanizmit. Edhe zoti Gashi, kryesuesi ka dhënë deklaratë për për çështje: Kryesuesi i asamblesë komunale në Klinë, z. Fadil Gashi thotë: Vendimi i asamblesë nuk është zbatuar. Kemi hartuar një vendim që të i anulohet të gjitha pëlqimet e dhëna për këtë çështje por deri sot nuk janë anuluar. Kemi një kallëzim penal pasi që po dyshohet se procesverbali i takimit me qytetarë është falsifikuar komplet, magjiti se lënda është në gjykatë , pëlqimet vazhdojnë të epën. Kallxo.com ka kërkuar këtë procesverbal në Ministrinë e ambientit por nuk e ka marrë. Sipas KPMNN këto kërkesa janë aprovuar nga bordi me datë 18 qershor ndërsa njoftimi për tërheqjen e pëlqimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës ka ardhur me 30 qershor. Ju faleminderit që më dëgjuat.

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje të gjithëve. Për temën për të cilën është thirr kjo seancë e jashtëzakonshme, ne të gjithë shefat e grupeve kuvendare opozitare jemi konsultuar paraprakisht bashkë edhe me grupin e qytetarëve. Ne si grup kuvendar vlerësojmë se është shumë e nevojshme që ekzekutivi të na jep sqarime për këtë çështje dhe qytetarët e Klinës ta kenë të qartë. Është një projekt që do të përcjell breza të tërë. Shqetësimi ynë ka lindur duke i parë edhe hapat që janë ndjekur deri tek



dhënia e lejes. Si kuvend kemi pasur një deklaram unanin dhe kemi marrë një vendim unanin për tërheqjen e të gjitha lejeve të dhëna. Derisa vendimi ynë ka qenë në fuqi, është proceduar me hapat e dhënies së lejes. Debatet e mbajtura nuk kanë shkuar mirë ka pasur ngatërresa nga panelistët dhe qytetarët.

**Znj. Arta Pantina:** Përshëndetje. Duke vlerësuar situatën ekonomike në republikë dhe komunë të Klinës besoj që çdo iniciativë për të krijuar vende të lira të punës është një shpresë për të rinjtë tonë. Prandaj hapja e një fabrike do të ndikonte shumë në punësimin dhe zvogëlimin e migrimit të të rinjve por hapja e një fabrike të çimentos duhet vlerësuar bazuar në vlerësimin që bëjnë ekspertet e kësaj fushe. Kjo fabrikë ndotë ambientin prandaj perspektiva e qytetarëve të Klinës është para se gjithash dhe unë si asamblistë jam në mbrojtje të qytetarëve të Klinës.

**Znj. Besiana Gashi:** Të nderuar të pranishëm. Qytetarët e Komunës sonë nuk kanë nevojë për një fabrikë e cila më shumë sjell dëme se sa të mira. Para se gjithash ne kemi nevojë të jetojmë në një ambient të shëndetshëm. Kemi të bëjmë me pasoja gjithëpërfshirëse, ndotjen e ajrit, ujit, tokës, humbjen e biodiversitetit etj. Do të kemi pasoja në shëndet që do të jenë kronike dhe akute. Unë si asamblistë jam kundër kësaj fabrike që dëmton shëndetin e qytetarëve.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje. Edhe ne si grup kuvendar i PDK-së kemi qenë iniciues i seancës së jashtëzakonshme në mars të vitit 2020 pas nënshkrimit të peticionit të mbi 5000 qytetarëve dhe prap edhe kësaj radhe jemi nënshkrues të kësaj seancë dhe jemi në vazhdimësi kundër kësaj fabrike e jo si disa akterë që në mars të 2020 ishin kategorik kundër ndërsa tani kanë ndryshuar qëndrimet. I nderuar kryetar i kuptoj rregullat por kërkoj që të i epet fjala një qytetari i cili përfaqëson grupin e qytetarëve për nënshkrimin e peticionit i cili është z. Ahmet Gashi. Gjithashtu kërkojmë që në përfundim të kësaj seance të dakordohemi që të krijojmë një komision për hetimin e të gjitha procedurave për dhënien e lejes së ndërtimit të fabrikës në fjalë.

**z. Valmir Bacaj:** Përshëndetje të pranishëm. Kryetari Elezaj ka qenë vazhdimisht në kontakt me qytetarët dhe pranë tyre duke u shprehur qartë gjithmonë se do të jetë në përkrahje të tyre dhe kërkesave të tyre. Ka qenë vet kryetari Elezaj që ka thirrur seancë të jashtëzakonshme në mandatin e kaluar në të cilën seancë kemi anuluar pëlqimet por që më pastaj na janë kthyer si të jashtëligjshme nga ministria e linjës përkatëse. Unë mendoj se duke u bazuar në planin zhvillimor komunal, Komuna e Klinës mund të lëshoj vetëm Pëlqim për rregullimin e dokumentacionit për aplikim për përputhshmërinë e aktiviteteve minerare në planin zhvillimor komunal. Plan ky i miratuar me datë 26. 12. 2015 kur në qeverisje ishte PDK. Madje në vitin 2016, ish kryetari i Komunës së Klinës gjatë një takimi me përfaqësuesit e një konsorciumi të kompanive Shqiptaro-Sllovene, kishte shprehur pajtim në parim që të ndërtohet fabrika e çimentos në Klinë. Duke e pasur parasysh se kompetencat për lëshuarën e lejes për një aktivitet të tillë, kompetencat i takojnë komisionit (KPM), unë propozoj që Lëvizja Vetëvendosje në Klinë të na aranzhoj një takim me kryeministrin Kurti në mënyrë që të gjendet një zgjidhje i këtij shqetësimi të qytetarëve në lidhje me fabrikën e çimentos. Sepse ka qenë vet Kryeministri Kurti që me datën 13 tetor 2021, në kohë fushate në Klinë ka deklaruar në një tubim elektorale, po e citoj: "Në Klinë do të ketë ndotje të madhe nga ajo fabrikë e cila me ne nuk mund të vazhdojë". Është koha që kryeministri ta mbaj këtë premtim. Që të bëhet zgjidhje e përhershme për këtë [problematikë adresa është në qeveri, Përkatësisht tek kryeministri Kurti.

**z. Esat Raci:** Për hir të korrektësisë të asaj që tha asamblisti Bacaj, nuk e ka thirr kryetari i Komunës seancën e jashtëzakonshme në vitin 2020 por Grupi i PDK-së.



**z. Fadil Gashi, kryesues:** Seancën e ka thirrur grup i asamblistëve përfshirë edhe kryetarin, këtë e kam theksuar edhe në seancë.

**z. Zafer Gashi:** Si zakonisht me mikun tim Valmirin pajtohem kur ai flet por kësaj radhe janë dy deklarime, me njërin nga to pajtohem plotësisht. Pra me datë 13 tetor, deklarata e kryeministrit Kurti e cila do të jetësohet qoftë edhe me dënimet e mundshme ligjori nëse gjendet se dikush ka bërë shkelje, Komuna apo kushdo qoftë. Sa i përket asaj se në qeverinë Kurti 1 dikush nga ministrat ka marr vendim pro kësaj fabrike, ma tregoni dokumentin.

**z. Valmir Bacaj:** Zaferi e ka keqkuptuar. Unë nuk thash që dikush nga qeveria Kurti 1 ka nënshkruar pro kësaj fabrike por se vendimin tonë të kuvendit për anulimin e pëlqimeve të dhëna e ka kthyer të jashtëligjshme ministria që udhëhiqet nga qeveria Kurti 1.

**z. Fadil Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Kronologjikisht, anëtarët e kuvendit që janë në këtë mandat, d.m.th. të rinj në mandat, disa herë edhe nga folësit u ceken institucionet. Ne në Kosovë i kemi dy pushtete lokale dhe qendrore. Qeveria lokale funksionon duke u bazuar në ligjin bazik, ligjin për vetëqeverisje lokale. Secili prej neve duhet ti kenë para sysh tri aspekte: 1. Aspekti Ekonomik, 2. Procedural dhe 3. Juridik dhe ligjor. Nuk është hera e parë që e diskutojmë këtë çështje, që jemi marrë me këtë dhe na ka dalë telashe. Për vete dhe subjektin kam bindje se aspekti ekonomik, ne jemi përcaktuar për zhvillim ekonomik por nuk do të thotë se duhet të shkelet ligji. Ne si shoqëri duhet të mendojmë për gjenerata që do të vijnë pas neve, atyre duhet të dimë se a jemi duke u lënë trashëgimi. Procedurat, drejtoria ka lëshuar një pëlqim, ne e kemi anuluar si kuvend, vendimin tonë e ka anuluar ministria. Ministria e pushtetit Lokal na e kanë anuluar vendimin dhe kanë kërkuar rishqyrtim dhe e kemi rishqyrtuar por kuvendi dhe anëtarët e kuvendit kanë qëndruar pranë vendimit të më parshëm, unanim. Prap është anuluar nga ministria. Një vit më herët i njëjti kuvend ka marrë vendim për anulimin e pëlqimeve për dhënien në shfrytëzim të resurseve në anën e majtë të rrugës dhe ministria e ka konsideruar të ligjshëm. Tani vendimin tonë për anën e majtë e ka konsideruar të jashtëligjshëm. Si ka mundësi që në anën e majtë bënë e në anën e djathtë nuk bënë. Çështja ka evoluar, kompania i është drejtuar KPMM dhe ata e kanë pajisur me licencat e duhura për afat deri në vitin 2045. Jo nga Komuna e Klinës por nga KPMM. Komuna e Klinës vetëm dokumentin e parë- pëlqimin e ka lëshuar dhe të fundit- lejen për ndërtim gjitha të tjerat licenca e pëlqime i kanë lëshuar ministrinë përkatëse. Çka ka ndodhë, prokuroria i ka pushuar hetimet ndaj kallëzimit të ngritur nga grupi i qytetarëve të peticionit. Por Ministria e jona në ka paditur neve si Kuvend. Ne i jemi përgjigjur padisë dhe ta dini 36 shkresa, prova i ka ofruar Komuna e Klinës n atë padi që na është bërë. Ne jemi nivel lokal, jemi të pafuqishëm, ne si kuvend jemi në gjykatë dhe gjykata do të vendosë nëse është ministria ose Kuvendi me të drejtën e tij prandaj të kufizohemi në vlerësim dhe analiza derisa lënda është në gjykatë. Me mirëkuptim për fund, është çështje e ndjeshme kjo por mos ti japim ngjyra politike. Nëse fabrika ndërtohet s' ka për tu ndërtuar vetëm për Gremnik por për tërë territorin e Klinës. Mos të rreshtohemi në taborë, jemi përfaqësues të popullit, kemi mandat dhe përgjegjësi e ta trajtojmë drejt këtë çështje. Duhet presim verdiktin e gjykatës. Si kuvend nuk jemi tërhequr nga vendimi ynë, jemi me ata nënshkrues të peticionit. Nëse na heq gjykata s' kemi çfarë të bëjmë.

**z. Zafer Gashi:** Të jemi të saktë kur i referohemi diçkaje. Ministria e pushtetit lokal nuk e ka anuluar vendimin tonë. Ma jepni dokumentin ta shohim. Pse jemi në gjykatë ?

**z. Fadil Gashi:** Neve na ka dërguar në gjykatë MPAL për mos tërheqje e Kuvendit nga vendimi i ynë. D.m.th., na ka dërguar në gjykatë shkaku i atij vendimi.



**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje të gjithëve. Morra fjalën qëllimisht që të pajtohem me gjithë atë që e thatë ju kryesues dhe diskutuesit . kërkoj që rreth fabrikës të respektohet ligji dhe ti kushtëzohet ndërtimi i asaj fabrike me të qenurit e re dhe të mos ndotë ambientin.

**z. Ahmet Gashi, përfaqësues i organizatorëve të protestës:** Faleminderit. Do të mundohet të fokusohen në prizmin e qytetarëve. Që në vitin 2012 qytetaria aktive ka reaguar kundër ndërtimit të fabrikës së çimentos. Në atë kohë në debatin që e ka thirrur kompania "Titan grup" kam marr pjesë edhe unë dhe kemi kundërshtuar. Kemi organizuar peticion në atë kohë dhe e kemi sjellë në Kuvend ku kuvendi ka marr vendim që mos të i epet leje. Edhe ministria e mjedisit e ka konsideruar të dëmshme ndërtimin e asaj fabrike dhe prej atëherë ne kemi menduar që ka marrë fund ideja e ndërtimit të një fabrike të çimentos në atë pjesë. Tani në rastin e ri, ne kemi mbledhë nënshkrimet në peticion, kemi angazhuar dy doktor shkence dhe një magjistër që të bëjë një raport- punim shkencor mbi pasojat e ndërtimit të fabrikës së çimentos. Një punim alarmant sepse industria e çimentos është sot një nga ndotësit më të mëdhenj në botë. Për informimin tuaj qeveria Gjermane i ka hequr të gjitha fabrikat e çimentos sepse me lirë po i kushton me e ble çimenton nga jashtë së sa shërimi i popullatës nga ndotja e këtyre fabrikave. Expertet po thonë edhe në raport shkencor se jeta pas ndërtimit të kësaj fabrike do të ndryshoj dramatikisht. Ndotja e ajrit dhe tokës do të jetë e pa evitueshme.

Sa i përket procedurës së ndaljes së vazhdimit të ndërtimit të kësaj fabrike, unë e kam pyet publikisht deputetin q ka qenë prezent në një takim këtu në këtë sallë, deputetin i cili ka qenë kryetar për legjislacion në atë kohë, z. Shkemb Manaj. Ai atë kohë pati deklaruar se për ndaljen e ndërtimit të kësaj fabrike janë dy mënyra. 1. Që Qeveria të intervenoj dhe 2. Asambleja komunale mund të i tërheq pëlqimet e dhëna. Edhe me jurisë jam konsultuar në lidhje me vendimin e asamblesë dhe edhe ata e thonë se vendimin që e prodhon asambleja mund ta anuloj vet asambleja ose gjykata. Tani kërcënimet dhe shantazhet nuk duhet të ndikojnë, vendimi i asamblesë është në fuqi dhe çuditë se si një zyrtar komunal merr guximin e jep leje ndërtimore për fabrikë të çimentos. Si ka mundësi që drejtorja e urbanizimit me dhënë leje e kushteve ndërtimore që i ka paraprirë lejes [për ndërtim derisa as gjykata nuk e ka shfuqizuar akoma vendimin e asamblesë? Kushtet ndërtimore të lëshuara nga Komuna ia kanë mundësi kompanisë që të vazhdojë të merr pëlqime të tjera nga ministria e ambientit. Një gjë tjetër që është për tu dënuar aq sa është e çuditshme se si mund të ndodhë. Në tubimin me qytetarë të thirrur nga operatori që e ka obligim, procesverbali nga ai takim del krejt pozitiv dhe thuhet se qytetarët prezent nuk kanë reaguar fare. E vërteta është krejt ndryshe. Unë kam qenë në atë takim dhe kemi reaguar ashpër. Gjithë takimi është i incizuar dhe ky është një material për prokurori. Dy orë e 40 min. është stenogrami i atij takimi, ne si organizator të protestave dhe peticionit e posedojmë këtë incizim. Të gjithë kanë kundërshtuar në atë takim, ndërsa në Ministrinë e ambientit është procesverbali ku ata e kanë shkruar se qytetarët nuk kanë reaguar por janë pajtuar me ndërtimin e kësaj fabrike. Për këtë ata duhet të japin llogari para organeve të drejtësisë sepse që në takimin me qytetarë fillon shkelja e ligjit dhe falsifikimi i procesverbalit. Në qershor të vitit 2020 e kemi marrë një dokument që edhe komuna e ka marrë gjithashtu nga Ministria e ambientit e cila ministri e "kërcënon" kuvendin që ta anuloj vendimin e marsit sepse nëse mbetet në fuqi vendimi për anulimin e pëlqimeve atëherë komuna do të humb investitorë të jashtëm e gjithashtu do të shkoj në penallti sikurse PTK. Në Janar është marr leja e fundit ajo e ndërtimit , kjo është bërë duke qenë lënda në gjykatë, absurde e tëra. Kam me dhjetëra materiale e incizime. Ne kur e kemi nisur peticionin kundër kësaj fabrike jemi bazuar në Kushtetutën e Republikës sonë e cila thotë decidivisht: Neni 52: Qytetarët e Republikës së Kosovës, participojnë në vendim marrje për çështje të ambientit 50% me 50% me qeverinë. Pra ne jemi vendimmarrës me 50%



dhe nëse qytetarët nuk lejojnë një ndërtim apo ndotës së ambientit, ne kemi të drejt vetoje për atë vendim. Ne jemi mbledhur, kemi angazhuar ekspertë, janë bërë analiza e studime shkencore dhe kemi bindur edhe këtë kuvend që të merr vendimin që e ka marr. Tani disa akterë thonë se nëse nuk kemi zgjidhje duhet të gjejmë diku një fabrike të re. Kane ndryshuar qëndrimin. Ju lutem fabrikat e kësaj natyre nuk falin, ato vrasin. Për fund, kërkesa ime dhe e grupit, këtë material që unë e kam në dorë të merret dhe të dërgohet në prokurori. Ta heqim dilemën e mos ndërtimit të kësaj fabrike përndryshe, ne aty dhe fabrika aty nuk mund të qëndrojmë. Do të detyrohemi të i hypim makinave, traktorëve dhe të ikim nga vendlindja. Krejt në fund unë e falënderoj deputeten Fitore Pacolli e cila na ka përkrahur dhe na ka furnizuar me dokumentacionin që komuna nuk na e ka dhënë. Shpresoj që kjo ëndërr e keqe ka me marr fund me një epilog të mirë për qytetarët e Komunës së Klinës.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Dëshiroj të bëjë një ndërhyrje të lehtë. Krejt fjala e zotërisë i referohet nivelit qendror. Pasi që e përmendet Fitore Pacollin, ajo vërtetë ka kërkuar dokumente nga ne, i ka amrrur ato por deri sot asgjë nuk ka bërë. Ky kuvend s' ka çfarë të bëjë më shumë. E ka anuluar pëlqimin.

**z. Esat Raci:** Propozimin e dytë për formimin e komisionit që e thash më herët. Për heqjen e të gjitha dyshimeve kërkoj që të formohet një komision nga të gjitha grupet kuvendare dhe një përfaqësues nga grupi i organizuar i qytetarëve. Ky komision ti bëjë të gjitha hetimet e duhura. Ky komision të vërtetoj nëse ka pasur shkelje gjatë procedurave të dhënies së pëlqimeve.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Përhëndetje për të gjithë. Ndoshta është pak vështir të jap përgjigje për të gjitha këto që u ngritën por do të mundohem që të qartësoj sa më shumë që të mundem. Komplet procedura, vendimet dhe materiali ju është dërguar edhe udhëheqëses së Komisionin parlamentar znj. Fitore Pacollit edhe të gjitha organeve që i kanë kërkuar ato. Pëlqimin që e ka lëshuar komuna është pëlqim i natyrës formale sikurse janë lëshuar edhe në të kaluarën. Lejen ndërtimore Komuna e ka konsideruar që nuk është e drejtë e saj që ta lëshoj për resursin në fjalë por ministria e mjedisit na është drejtuar më shkresë dhe na ka detyruar që komuna ta lëshoj, e kanë argumentuar që është detyrë e jona. Edhe kryesuesi e tha, vendimi që kemi marr në 2020 për anulimin e pëlqimeve ka dalë që është antiligjor dhe është vlerësuar nga Ministria e pushtetit Lokal dhe Ministrinë e linjës. Ne nuk guxojmë me e implementu një vendim antiligjor i cili është vlerësuar i tillë nga niveli kompetent qendror. Sa i përket falsifikimit të procesverbale etj. nuk i takon Komunës ajo punë. Komuna e ka lëshuar fillimisht një pëlqim e ku më pastaj Ministria e mjedisit i ka lëshuar dy pëlqime. Një pëlqim është dhënë për shfrytëzimin e lëndës minerare dhe pëlqimi tjetër është dhënë për ndërtimin e fabrikës së cementit ku janë paraparë edhe normativat. Ne duhet të respektojmë vlerësimet mjedisore që bëhen nga njerëz me licencë e kompetent të autorizuar nga Ministria e Mjedisit. Unë i vlerësoj dhe respektoj të gjithë ata emra që i përmendi Ahmeti në raportin e studimit, por ai dokumentacion është dashur që të i dërgohet ministrisë së mjedisit, janë emra që meritojnë respekt por është dashur të ndiqet rruga ligjore. Ne, si komune kemi lëshuar kushtet e ndërtimit dhe çdo dokument që bazohet në kushtet e ndërtimit, ndërsa kompania ka plotësuar të gjitha dokumentet nga niveli qendror. Ne kemi përgatitur një kronologji me të gjitha dokumentet, drejtori i Urbanizmit mund të jep detajet nëse dëshironi. Përndryshe jam i gatshëm dhe dakord për çdo hetim që duhet të bëhet sepse kjo materie është hetuar edhe nga prokuroria e Kosovës dhe është mbyll procesi. Jemi të gatshëm që çdo vendim që merr Kuvendi për hetim të respektojmë.

**z. Zafer Gashi:** Disa argumente është mirë që më të vërtetë të jenë argumente. Të thuash se Ministria e Ambientit na ka detyruar me shkresë të veçantë të lëshojmë leje ndërtimi është mirë që ta shikojmë.



Pajtohem që keni të drejtë që ka pasur shkelje në nivel qendror, edhe zoti Raci po kërkon që të i kërkojmë dokumentet, ti shqyrtojë ai grup si ta quani hetimor apo hetues. Nëse gjënë shkelje të i dërgojmë në prokurori.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Unë e thash decidivisht se me shkresë me argumente ligjore, pra është argumentuar se niveli komunal është kompetent për lëshuarën e lejes. Gjithçka çka kërkohej jemi të gatshëm sido që ta quajmë, komision apo grup hetimor. Përfundimisht jua porosis se hetimet janë mbyllur për një zyrtar komunal në lidhje me këtë. Nëse jeni përcaktuar që të formoni komisionin e tillë hetimor, ne jemi dakord.

**z. Esat Raci:** Unë qëndroj pranë propozimit tim që të formohet komisioni dhe në një seancë të radhës të na raportoj këtu në asamble.

**z. Kolë Prenaj:** Përshëndetje të gjithëve. Kjo seancë e jashtëzakonshme është shumë e rëndësishme. Kemi ardhur në piken që të formohet një komision. Unë jam kundër formimit të këtij komisioni. Sepse Komuna dhe të gjithë ne kemi nevojë për investitorë. Po jetojmë në Kosovë, pavarësisht dallimeve politike kur po vjen puna po gjejmë marrëveshje. Ku është fajtori në lidhje me fabrikën? A kanë faj politikanët tanë, biznesmenët apo AKP. Kush ka drejt me ndryshuar strukturën e tokës? - Ministria e bujqësisë, Kush merret me planifikimin hapësinor të Komunave? - Ministria e planifikimit hapësinor. Kush e monitoron Kuvendin Komunal? - Ministria e Pushtetit Lokal. Unë plotësisht e përkrahu kryetarin dhe kryesuesin që dhanë sqarimet. Janë dokumentet, e ka domethënien e vet se si janë lëshuar lejet. Unë mendoj që gjykata është duke u marr me këtë punë, është mirë edhe avokati i popullit të merret me këtë punë. Ne jemi të gjithë edhe për ambient të pastër por edhe për shqetësim. Kjo nuk është shqetësim vetëm i qytetarëve por edhe i kryetarit njëkohësisht.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Kolë, nuk është mirë të ndahesh nga anëtarët e Kuvendit, as nga propozimi, as nga kryetari. Nuk ka asgjë të keqe që të formohet ai komision dhe të kufizohet në përgjegjësitë tona që i ka Komuna, d.m.th. në nivelin lokal. Janë këto dokumente që u thanë, i tha edhe kryetari edhe mund të jua thotë drejtori ose secili anëtarë që nga mandati i kaluar, e kanë dit edhe e dinë kronologjinë e akteve dhe vendimeve. Ne duhet me bashkëjetuar me njerëzit tanë por kjo s' do të thotë që ne me qar mesazh të keq tek ata që akne ndërmend të investojnë në Klinë. Pra duhet të jemi të kujdesshëm që të mos mendoj një investitor tjetër me krejt një veprimtari tjetër se ne marrim vendim dhe anulojmë. Unë jam pro ndërtimit të atij komisioni dhe të shikohet lënda komplet prej fillimi e deri në fund.

**z. Esat Raci:** Pjesën më të madhe e the zoti kryesues dhe i dhe sqarimet. Asgjë të keqe nuk ka që edhe ne të gjithë anëtarët e kuvendit ti kemi dokumentet dhe ta dimë se si ka shkuar procedurat e dhënies së lejes. Nëse ka pas shkelje të përgjigjet gjithkush.

**z. Valmir Bacaj:** Edhe ne si grup kuvendar i AAK-së jemi pro themelimit të këtij komisioni për hir të transparencës me qytetarë edhe pse pak besojmë që do të ketë rezultat ky komision pasi që lënda është në gjykatë si dhe komisioni në nivel parlamentar duhet të merret me këtë çështje.

**z. Arben Limanaj:** Edhe ne si grup kuvendar i LDK-së jemi pro themelimit të këtij komisioni.

**z. Zafer Gashi:** Edhe grupi i LVV pajtohet që të themelohet komisioni në fjalë.

**Kryesuesi e vuri në propozim që komisioni të përbehet nga pesë anëtarë dhe me 26 vota për u MIRATUA.**

Komisioni u propozua në këtë përbërje:

1. Valmir Bacaj, 2. Bledar Berisha, 3. Ndrec Zefaj, 4. Zafer Gashi, 5. Enver Gashi

Komisioni i propozuar u vendos në votim dhe me 25 vota për , 1 abstenim( Kolë Prenaj), asnjë kundër U MIRATUA.

Kryesuesi theksoi se komisioni bazohet në ligji, mandat dh afat. Ata sjellin një raport në kuvend dhe e zgjedhin vet kryesuesin e komisionit. Kryesuesi Gashi falënderoj të gjithë për pjesëmarrje. Seanca mbaroj punimet.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

